

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Driton Muharremi, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues, e Mejreme Memaj, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarve L.R. dhe A.R., që të dy nga fshati ..., për shkak të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist, nga neni 143 par.2 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ankesës së mbrojtëses së të pandehurit av.S.K. kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.101/2016, të dt.09.02.2017, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me datën 09.11.2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohen ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ankesa e mbrojtëses së akuzuarit L.R. i av.S.K. kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.101/2016, të dt.09.02.2017, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.101/2016, të dt. 09.02.2017, të akuzuarit L.R. dhe A.R., janë shpallur fajtor secili veç e veç për veprën penale organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist, nga neni 143 par.2 të KPRK-së, për të cilën veprë janë gjykuar secili me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 1(një)viti e 6(gjashtë)muaj, të cilin dënim të akuzuarit do ta vuajnë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit janë obliguar që ti paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga 40Euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat kanë paraqitur ankesë:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovojë ankesën, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarve t'iu shqiptojë dënime me të rënda me burg efektiv.

Mbrojtësja e të akuzuarit L.R., av.S.K. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit t'iu shqiptojë dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.373/2017, të datës 11.08.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e PRSK dhe mbrojtëses së të akuzuarit, ka propozuar që ankesa e PRSK të aprovohet, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet dhe të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime më të rënda, me të cilat do të arrihet qëllimi i dënimit, ndërsa të refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit L.R., si e pabazuar, meqë nuk qëndrojnë pretendimet e cekura si në ankesë.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën morën pjesë të akuzuarit L.R.i dhe A.R., si dhe mbrojtësit e tyre, av.S.K. dhe T.Q., ndërsa ka munguar Prokurori i Apelit-DKR në Prishtinë, edhe pse ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo, në sqarimin e tij me shkrim ka propozuar që ankesa e PRSK të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarve t'iu shqiptohet dënimi më i ashpër, ndërsa ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit L.R., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e PRSK dhe të mbrojtëses së të akuzuarit L.R., av.S.K. edhe sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, e duke marrë parasysh edhe sqarimin me shkrim të Prokurorit të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, e pas shqyrtimit dhe vlerësimit edhe shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesat e PRSK dhe e mbrojtëses së të akuzuarit L.R., janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të pandehurit, e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e saj.

PRSK në bazën ankimore lidhur me sanksionin penal, pretendon se gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit, nuk ka aplikuar drejt ligjin penal, se gjykata e shkallës së parë, me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin gjyqësor, këtë rrethanë e ka vlerësuar si posaçërisht lehtësuese e cila dallon nga rrethanat e rëndomta lehtësuese, pasi në rastin konkret nuk ekzistojnë ato rrethana posaçërisht lehtësuese se të akuzuari veprën penale e kanë kryer me dashje. Gjykata e shkallës së parë, si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë, sjelljen në gjykatë të cilat i ka mbi vlerësuar, e të cilat rrethana nuk arsyetojnë dënimin e shqiptuar prej 1(një)viti e 6(gjashtë)muaj burgim, për arsye se dënimi i paraparë për këtë veprë penale është prej 5(pesë)vite deri në 10(dhjetë)vjet, e në llogaritjen matematikore në përqindje se të akuzuarit janë dënuar në lartësi prej një të tretat e minimumit të dënimit të paraparë për këtë veprë penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit L.R., av.S.K. në bazën e saj ankimore, mbi sanksionin penal, pretendon se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit L.R., i ka shqiptuar dënim të lartë, duke marrë parasysh se i njëjti asnjëherë nuk ka qenë i dënuar dhe nuk ka ra ndesh me ligjin, se është i moshës së re, se është student, i gjendjes tejte të dobët ekonomike, si dhe thellë është pënuar për veprimet e veta dhe ka pasur qëllim korrekt dhe bashkëpunim me organet e drejtësisë.

Gjykata e Apelit, duke i vlerësuar ankesat e PRSK dhe të mbrojtëses së të akuzuarit, lidhur me vendimin mbi dënimin, gjen se gjykata e shkallës së parë, ia ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 6(gjashtë)muaj, të cilat dënime të shqiptuara të akuzuarve L.R.i dhe A.R., janë nën minimumin e paraparë ligjorë. Gjykata e Apelit, vlerëson se dënimet e tilla të shqiptuara edhe nën minimumin e paraparë ligjor, ato janë shqiptuar në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të nenit 75 par.1 nën par.1.3 të KPRK, kjo për arsye se gjykata me rastin e pranimit të fajësisë sa i përket zbutjes së dënimit, gjykata nuk detyrohet nga kufizimet e parapara si në nenin 76 të KPRK-së, e që ka të bëjë me kufijtë e zbutjes së dënimit i cili dënim i shqiptuar është nën minimumin e paraparë ligjorë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, PRSK dhe mbrojtëses së të akuzuarit, në ankesat e tyre, nuk paraqesin asnjë rrethanë rënduese, respektivisht lehtësuese që kishite me ndikuar në ashpërsimin e dënimit apo zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarve L.R.i dhe A.R. dhe pretendimet ankimore janë të pabazuara, për arsye se gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuadër të rregullave të përgjithshme mbi matjen e dënimit, të paraparë si në nenin 73 të KPRK, e në lidhje me nenin 75 par.1 nën par.1.3 të KPRK, e duke marrë parasysh se të akuzuarit, kanë pranuar fajësinë, janë penduar për veprat penale të cilat i kanë kryer, se dy të akuzuarit kanë premtuar se nuk do të përsërisin vepra penale të këtilla apo të ngjashme, e nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese nuk kanë marrë pjesë aktive në ndonjë luftë, kështu që nuk kemi pasoja të dëmshme, duke marrë parasysh faktin se sjelljet e tyre të mëparshme kanë qenë në harmoni me dispozitat ligjore pozitive të shoqërisë dhe asnjëherë nuk kanë ra ndesh me ligjin dhe të akuzuarit në vitin 2014 janë kthyer në Kosovë dhe nuk janë marrë me asnjë aktivitet të tillë, dënimet e shqiptuar secilit prej të akuzuarve me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 6(gjashtë)muaj, janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe dënimet e tilla të shqiptuara do ti shërbejnë preventives individuale që të akuzuarit në të ardhmen mos të përsërisin vepra penale të këtilla apo të tjera, si dhe preventivës së përgjithshme, që dënimi i këtitillë të ndikojë edhe tek të tjerët në parandalimin e kryerjes së këtyre veprave penale, dhe pritet në tersi të arrihet edhe qëllimi i dënimit i paraparë si në nenin 41 të KPRK-së.

Si u cek edhe më lartë, u deshtë, që ankesa e PRSK dhe e mbrojtësit të pandehurit të refuzohen si të pa bazuara dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, në bazë të nenit 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.389/2017, me dt.09.11.2017

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Mejreme Memaj

Kryetari i Kolegjit,

Driton Muharremi